



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGJENCIA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	03/12/2015
REFERENC-Ë:	AKK - DPKPP – 03-03/4494/15
PËR/ZA/TO:	z. Salih KQIKU Drejtor i Departamentit të Prokurimit - Komuna Gjilan
CC:	z. Lutfi HAZIRI Kryetar Komune – Komuna Gjilan
NGA/OD/FROM:	<i>për</i> Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin: “Furnizim me barëra dhe pajisje mjekësore për nevoja të QKMF-së”

I nderuari z. KQIKU,

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nën par. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4; 9 par. 1, nën par. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nën par. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin: “Furnizim me barëra dhe pajisje mjekësore për nevoja të QKMF-së” me numër prokurimi: G1651/12/111/121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t’i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin: “Furnizim me barëra dhe pajisje mjekësore për nevoja të QKMF-së” me numër prokurimi: G1651/12/111/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik dhe të akteve tjera nënligjore që derivojnë nga ky ligj.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna e Gjilanit, bazuar në nevojën e sajë për furnizim me barëra dhe pajisje mjekësore për nevoja të QKMF-së, për këtë aktivitet ka paraparë furnizim, me procedurë të hapur. Njoftimi për Kontratë i publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik mban datën 13/11/2015.

Në Njoftim për Kontratë në pikën III.2.4 Kapaciteti teknik dhe profesional, nën-pika 3) kërkohet: *Produktet e ofruara duhet të jenë të prodhuara ose të regjistruara në shtetet e BE (vendet e zonës Shengen), Zvicër, SHBA, Australi, Kanada, Turqi, Izrael, Japoni, Britani e Madhe.* Me udhëzimin administrativ Nr. 01/2015 Autorizim Marketingu për Produkte Medicinale është i caktuar për shtetet BE-së, nga zona Shengen-it si dhe SHBA-të. Autoriteti Kontraktues ka përfshirë edhe vende tjera në kërkesën e tij gjë që bie ndesh me legjislacionin në fuqi. Me që aktiviteti i prokurimit është ndarë në dy lote, njëri lot për barëra dhe tjetri për pajisje, Autoriteti Kontraktues ka mund ta përdor këtë kufizim (sipas UA Nr.01/2015) për lotin e parë, ndërsa për lotin e dytë vendi i origjinës nuk mund të jetë si kriter. Pra, udhëzuesi i lartë cekur flet për produktet medicinale, por jo edhe pajisjet medicinale. Agjencia nuk ka gjetur elemente që ky udhëzim administrativ e mbulon edhe furnizimin me pajisje medicinale. Si i tillë ky kriter është diskriminues, favorizon operator të caktuar ekonomik dhe në të njëjtën kohë diskriminon të tjerët.

Ky aktivitet i prokurimit nuk është i planifikuar paraprakisht nga autoriteti kontraktues dhe nuk janë marrë veprimet e nevojshme që merren në raste të tilla. Për autoritetet kontraktuese që janë autoritete publike ose ndërmarrje publike, nëse objektet e aktivitetit të prokurimit nuk janë përfshirë në planifikimin përfundimtar të autoritetit kontraktues, Zyrtari Kryesor Administrativ do të dërgojë në Agjencinë Qendrore të Prokurimit një kopje të Deklaratës përkatëse të Nevojave dhe Vendosmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve së paku pesë ditë para se Zyrtari Autorizues të autorizojë Zyrtarin e Prokurimit për inicimin e aktivitetit përkatës të prokurimit. Një veprim të këtillë autoriteti kontraktues Komuna e Gjilanit nuk e ka ndërmarrë.

Tutje, autoriteti kontraktues Komuna e Gjilani në “Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve” nuk ka siguruar nënshkrimin e Zyrtarit Kryesor Financiar, i cili do të siguronte se ka mjete të mjaftueshme financiare për realizimin e prokurimit në fjalë. Pra, Zyrtari Kryesor Financiar duhet që formalisht të siguroj që janë përvetësuar mjetet për prokurimin në fjalë në një shumë të mjaftueshme për të përmbushur obligimet financiare që mund të rrjedhin gjatë periudhës së vitit të tanishëm fiskal si rezultat i këtij prokurimi.

Komuna e Gjilanit, si Autoritet Kontraktues ka obligim ligjor që ti merr gjitha masat e duhura që në aktivitetet e prokurimit mos të ketë kritere jashtë kuadrit ligjor të prokurimit publik dhe ligjeve tjera specifike që janë objekt trajtimi.